

Shufra altoparlant

PARALAJMËRIM

Mos instaloni aparatin në vend të mbyllur, si raft për libra ose vitrinë të integruar.

Për të ulur rrezikun nga zjarri, mos i mbyllni hapjet për ventilim të aparatit me gazeta, mbulesa, perde etj. Mos ekspozoni aparatin në burime të flakës (për shembull, qiri të ndezur).

Për të ulur rrezikun nga zjarri ose shoku elektrik, mos e ekspozoni aparatin në pika ose spërkatje dhe mos vendosni gjëra të mbushura me ujë siç është vase mbi aparatin.

Njësia nuk është larguar nga rryma kryesore për derisa është lidhur me prizën e murit, madje edhe nëse njësia është shkryçur tërësisht.

Meqë kyçësja kryesore përdoret për të larguar njësinë nga priza, lidhjeni njësinë në prizë të hapur që kapet lehtë. Nëse vëreni ndonjë parregullsi në lidhje me njësinë, largojeni nga priza e murit menjëherë.

Mos ekspozoni bateritë ose aparatin në ngrrohtësi të madhe siç janë dritë e diellit, zjarr ose diçka të ngjashme.

Për përdorim vetëm brenda.

Kordonë të rekomanduar

Duhet të përdoren kordonë të mbuluar mirë dhe të tokëzuar për lidhje të kompjuterëve kryesor ose pjesët periferike.

Kjo pajisje është testuar dhe gjetur që përputhet me kufizimet e caktuar në EMC Direktivën për përdorim të kordonit lidhës më të shkurtë se 3 metra.

Shënime për konsumatorët: informatat vijuese vlejné vetëm për pajisjet e shitura në shtetet që zbatojné direktivat e BE-së.

Ky produkt është prodhuar nga ose në emër të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Përfaqësuesi i autorizuar për EMC dhe siguri të produktit Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çështje servisimi ose garanci ju lutemi drejtohuni në adresën e dhënë në dokumentet e veçanta për servisim ose garancinë.



Me këtë, Sony Corp., deklaron që ky aparat është në përputhje me kërkesat thelbësore dhe dispozitat tjera relevante të Direktivës 1999/5/EC. Për detaje, shikojeni URL lidhjen më poshtë:

<http://www.compliance.sony.de/>



Largimi i pajisjes së vjetër elektrike dhe elektronike (vlejnë për Bashkimin Evropian dhe shtete tjera evropiane me sisteme të ndarë të grumbullimit)

Ky simbol në produktin ose paketimin tregon që produkti nuk duhet të hidhet bashkë me mbeturinat e shtëpisë. Në vend, duhet të dërgohet në vendin përkatës për grumbullim për riciklim të pajisjes elektrike dhe elektronike. Duke siguruar që produkti largohet mirë, do të ndihmoni në parandalimin e konsekuencave potenciale negative për

mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve, e cila mund të dëmtohet nga trajtimi i gabuar i mbeturinave të këtij produkti. Materialet për riciklim do të ndihmojnë të mbrohen resurset natyrore. Për informata më të hollësishme mbi e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni zyrën lokale civile, shërbimin për grumbullimin e mbeturinave ose dyqanin në të cilin keni blerë produktin.



Largimi i baterive (vlejnë për Bashkimin Evropian dhe shtete tjera evropiane me sisteme të ndarë të grumbullimit)

Ky simbol në bateritë ose në paketimin tregon që bateritë e dhëna me këtë produkt nuk duhet të trajtohet sikur mbeturina shtëpiake.

Për disa bateri, ky simbol mund të përdoret në kombinim me një simbol kimik. Simboli kimik për zhivë (Hg) ose plumb (Pb) mund të shtohen nëse bateria përmban më tepër se 0.0005% zhivë ose 0.004% plumb. Duke siguruar që produkti largohet mirë, do të ndihmoni në parandalimin e konsekuencave potenciale negative për mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve e cila mund të dëmtohet nga trajtimi i gabuar i mbeturinave të këtij produkti. Materialet për riciklim do të ndihmojnë të mbrohen resurset natyrore. Nëse produktet për shkaqe sigurie, performancë ose integritet të të dhënave kërkojnë lidhje permanente me bateri të inkorporuar, këtë bateri duhet të ndryshohet nga teknik i kualifikuar. Për të siguruar që bateria do të trajtohet mirë, dorëzoni produktin në fund të jetës në pikë përkatëse për grumbullim për riciklim të pajisjes elektrike dhe elektronike.

Për gjitha bateritë tjera, ju lutemi shikoni pjesën për largimin e baterisë nga produkti në mënyrë të sigurt. Dorëzoni baterinë në pikën përkatëse për grumbullim për riciklimin e baterive të vjetra. Për më tepër informata mbi riciklimin e këtij produkti ose baterisë, ju lutemi kontaktoni zyrën lokale për shërbime, kompaninë për mbeturin ose shitoren në të cilën keni blerë produktin.

Përmbajtja

Masa kujdesi.....	5
BLUETOOTH teknologjia pa tel	7
Instalimi i shufrës altoparlant në mur.....	8
Përdorimi i funksionit Control for HDMI	10
Përdorimi i “BRAVIA” Sync veçorive	10
Mënjanim i problemeve.....	11
Specifikimet	13

Masa kujdesi

Mbi sigurinë

- Nëse ndonjë gjë e fortë ose ujë bie në sistemin, largojeni sistemin nga rryma dhe dërgojeni për kontroll nga personi i kualifikuar para se të vazhdoni me përdorimin.
- Mos u ngjitni në Shufrën e Zërit ose subwoofer, sepse mund të rrëzoheni dhe lëndoheni ose të dëmtoni sistemin.
- Mos vendosni asnjë mbi sistemin.
- Mos vendosni asnjë në vrimat (ventilimi qendror ose vrimat e ventilimit në Pjesën mbrapa) e sistemit.
- Meqë sistemi dridhet gjatë punës, vendosni në mënyrë që mos të rrëzohet rastësisht.

Mbi burimin e rrymës

- Para përdorimit të sistemit, kontrolloni nëse voltazhi i operimit është identik me rrymën e juaj. Voltazhi i operimit është dhënë në pllakën me emrin në pjesën mbrapa Shufrës së Zërit.
- Largoni njësinë nga priza kryesore nëse nuk planifikoni të përdorni për një periudhë të gjatë. Për të larguar, kapeni tek kyçësja dhe asnjëherë për teli.
- Njëra majë e kyçësës është më e gjerë se tjera për qëllime sigurie dhe mund të kyçet në prizë vetëm në një drejtim. Nëse nuk mund të vendosni kyçësen tërësisht në prizën, kontaktoni distributorin e juaj.
- Kordoni i rrymës duhet të ndryshohet vetëm nga servisi i kualifikuar.

Mbi gjenerimin e ngrohjes

Ndonëse sistemi ngrohet gjatë përdorimit, kjo nuk është defekt. Nëse vazhdimisht e përdorni këtë sistem me zë të lartë, temperatura e sistemit në fund dhe mbrapa do të rritet dukshëm. Për të shmangur djegien, mos e prekni sistemin.

Mbi vendosjen

- Duhet të ketë mjaft hapësirë rreth sistemit për të lëshuar ngrohjen. Kur të vendosni sistemin në raft, lini së paku 5 cm hapësirë mbi sistemin dhe më Tepër se 5 cm hapësirë anash sistemit. Rafti pas sistemit duhet të jetë hapur.

Nëse e vendosni sistemin me shpinë afër murit, lini së paku 10 cm mes sistemit dhe murit.

• Lini pjesën përpara të sistemit të hapur.

- Mos vendosni sistemin mbi aparate që gjenerojnë ngrohtësi.
- Vendosni sistemi në vend me ventilim adekuat për të parandaluar ngrohjen e sistemit dhe të vazhdoni jetën e sistemit.
- Mos instaloni sistemin afër burimeve të ngrohtësisë ose vende tjera që janë në dritë direkte të diellit, pluhurit të madh, dridhje mekanike ose shok.
- Mos vendosni asgjë mbrapa Shufrave të zërit sepse mund të bllokohet vrimat e ventilimit dhe të shkaktojë defekt.
- Nëse sistemi përdoret në kombinim me TV, VCR ose kasetofon, mund të rezultojë me zhurmë, dhe cilësia mund të pësojë. Në këtë rast, vendosni sistemin më larg TV, VCR, ose kasetofonit.
- Kini kujdes gjatë vendosjes së sistemit në sipërfaqe që janë të trajtuara (me dyllë, vaj ose shkëlqim, etj.) sepse mund të rezultojë me njolllosje ose humbje e ngjyrës.
- Kujdes që të shmangni lëndime nga skajet e Shufrave të Zërit ose subwoofer.

Mbi përdorimin e subwoofer

Mos vendosni dorën në hapjen e subwoofer kur të kapni. Drajveri i altoparlantit mund të prishet. Kur të kapni, kapeni nga poshtë.

Mbi përdorimin

Para lidhjes së pajisjeve tjera, siguroni që të shkyçni dhe largoni nga priza sistemin.

Nëse hasni çrregullime të ngjyrës në TV ekranin e afërt

Mund të vërehen çrregullimet të ngjyrës në disa lloje të TV aparateve.

Nëse vërehet çrregullimi i ngjyrës...

Shkyçeni TV aparatin dhe pastaj kyçeni sërish pas 15 deri 30 minutave.

Nëse çrregullimi i ngjyrës sërish vërehet...

Vendosni sistemin më larg TV aparatit.

Mbi pastrimin

Pastrojeni sistemin me leckë të butë dhe të thatë. Mos përdorni lëndë abrazive, pluhur ose tretës si alkool ose benzinë.

Nëse keni ndonjë pyetje ose problem lidhur me sistemin e juaj, ju lutemi të konsultoni distributorin më të afërt Sony.

Të drejta të autorit

Ky model inkorporon Dolby* Digital dhe DTS** Digital Surround System.

* Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Dolby dhe D e dyfishtë simboli janë shenja dalluese të Dolby Laboratories.

** Prodhuar me licencë me patentin e SHBA nr. 5,956,674; 5,974,380; 6,226,616; 6,487,535; 7,212,872; 7,333,929; 7,392,195; 7,272,567 & dhe patenta tjera të SHBA dhe në botë të dhënë dhe në pritje. DTS-HD, Simboli, & DTS-HD dhe simboli janë shenja dalluese të DTS, Inc. Produkti përfshin softuer. © DTS, Inc. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

BLUETOOTH® fjala dhe logot janë shenja të regjistruara në pronësi të Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre shenjave nga Sony është me licencë.

Ky sistem inkorporon High-Definition Multimedia Interface (HDMI™) teknologji. Termi HDMI dhe HDMI High-Definition Multimedia Interface, dhe HDMI Logo janë shenja të dalluara ose regjistruar të HDMI Licensing LLC në Shtete e Bashkuara dhe vende tjera.

“BRAVIA” logo është shenjë e Sony Corporation.

“x.v.Colour” and “x.v.Colour” logo janë shenja të Sony Corporation.

N Mark është shenjë ose shenjë e regjistruar e NFC Forum, Inc. në Shtete e Bashkuara dhe vende tjera.

Android është shenjë e Google Inc.

© 2012 CSR plc dhe kompanitë e grupit. aptX® shenja dhe aptX logo janë shenja të CSR plc ose ndonjë të kompanive të grupit dhe mund të regjistrohet në një ose me tepër juridiksione.

Shenjat tjera dhe emrat tregtar janë të pronarëve të tyre përkatës.

BLUETOOTH teknologjia pa tel

BLUETOOTH versione dhe profile të përmbajtura

Profilat janë mundësi standarde për produkte të ndryshme BLUETOOTH. Shikoni "Specifikime" (faqe 13) për versionin BLUETOOTH dhe profilet e përmbajtura nga ky sistem.

Shënime

- Për të mundur të përdoret BLUETOOTH funksionin, aparati BLUETOOTH i lidhur duhet të ketë profilin e njëjtë si të sistemit. Ndonëse ekzistojnë profilet e njëjta, aparatet mund të dallohen në funksione varësisht nga specifikimet e tyre.
- Audio dëgjimi në këtë sistem mund të vonohet nga ajo e BLUETOOTH aparatit për shkak të veçorive të BLUETOOTH teknologjisë pa tel.

Diapazoni maksimal i komunikimit

Kushtet më poshtë mund të ndikojnë mbi ndjeshmërinë e komunikimit me BLUETOOTH.

- Ka ndonjë pengesë si person, metal ose mur mes njësive dhe BLUETOOTH aparatit.
- LAN pa tel përdoret në afërsi të aparatit.
- Aparat furë mikrovalë që përdoret në afërsi të njësive.
- Një aparat që gjeneron valë elektromagnetike përdoret afër sistemit

Pengesa nga aparate tjera

Meqë BLUETOOTH aparatet dhe wireless LAN (IEEE802.11b/g) përdorin frekuencën e njëjtë, mund të ketë pengesë të mikrovalës dhe të rezultojë me keqësimin e shpejtësisë, zhurmë ose lidhje e gabuar nëse njësia përdoret afër wireless LAN aparateve. Në këtë rast, duhet të bëni hapat më poshtë:

- Përdorni njësienë së paku 10 m lart aparatit wireless LAN.

- Nëse njësia përdoret brenda 10 m nga wireless LAN aparati, shkyçeni atë aparat.

Pengesa mbi aparatet tjera

Mikrovalët që emetohen nga BLUETOOTH aparati mund të ndikojnë mbi përdorimi në aparateve elektronike mjekësore. Shkyçeni njësienë dhe BLUETOOTH aparatet në vendet më poshtë sepse mund të shkaktohet aksident.

- ku ka gaz ndezës, në spital, tren, avion ose pompë benzini
- afër dyerve automatike ose alarmit për zjarr

Shënime

- Ky sistem përmban aftësitë e sigurisë që përputhen me standardin BLUETOOTH për të siguruar një lidhje të sigurtë kur përdoret BLUETOOTH teknologjia, e megjithatë siguria mund mos të jetë e mjaftueshme varësisht nga parametrat. Kini kujdes gjatë komunikimit me BLUETOOTH wireless teknologjinë.
- Nëse nuk marrim asnjë përgjigje për rrjedhjen e informatave gjatë komunikimit me BLUETOOTH.
- BLUETOOTH komunikimi nuk garantohet me gjitha aparatet BLUETOOTH që kanë profilin e njëjtë sikur ky sistem.
- Një aparat me BLUETOOTH funksionin duhet të jetë sipas standardit BLUETOOTH të caktuar nga BLUETOOTH SIG, dhe të jetë autentik. Edhe nëse aparati i lidhur plotëson standardin e përmendur më lartë, disa aparate mund mos të lidhen ose punojnë mirë, varësisht nga veçoritë ose specifikimet e aparatit.
- Zhurmë ose kërcime mund të ndodhin varësisht nga BLUETOOTH aparati i lidhur me sistemin, mjedisit të komunikimit ose mjedisi i përdorimit.



Instalimi i shufrës altoparlant në mur

Mund të instaloni shufrën altoparlant në mur.

Shënime

- Përdorni vidha që janë të përshtatshme për materialin e muri dhe fuqinë. Si mur nga gipsi, ajo është mjaft e dobët dhe siguroni që të vendosni vidhat vetëm në shtyllë. Instaloni aparatit në mur vertikal dhe të përforcuar e të rrafshët.
- Siguroni që të angazhoni distributorët e Sony ose kompani të licencuar për dhe të keni kujdes për sigurinë gjatë instalimit.
- Sony nuk është përgjegjëse për aksidente ose dëmtime të shkaktuara nga instalimi i gabuar, dobësia e murit, vendosja e gabuar e vishave ose prishja natyrale, etj.


1 Përdatini vidhat (nuk jepen) që janë të përshtatshme për vrimat mbrapa shufrës altoparlant.




Vrima mbrapa aparatit

2 Vendosni vidhat në mur.

Vidhat duhet të jenë jashtë 8 deri 9 mm.




3 Vendosni mbulesat e dhëna në pjesën mbrapa Shufrës.



4 Vareni shufrën në vidhat.

Drejtoni vidhat mbrapa Shufrës sipas ato të vidhave, pastaj vareni Shufrën në 2 vidhat.



Përdorimi i funksionit Control for HDMI

Funksioni i kontrollit për HDMI mundëson TV aparati të komunikojë me pajisjen e lidhur që është kompatibel me funksionin Control for HDMI me anë të HDMI kordonit, përdorimi thjeshtësohet me operacionet më poshtë.

Shkyçje e sistemit

Kur të shkyçni TV aparatin me butonin e rrymës në telekomandën, sistemi dhe pajisja e lidhur shkyçen automatikisht.

Kontrollimi i zërit të sistemit

Nëse e shkyçni sistemin deri sa jeni duke shikuar TV, zëri i TV aparatit emetohet nga altoparantët e sistemit automatikisht. Zëri i sistemit rregullohet kur të rregulloni zërin e TV aparatit.

Nëse zëri i TV aparati ka qenë nga altoparantët e sistemit herën e fundit që keni shkyçur TV aparatin, sistemi kyçet automatikisht kur të kyçni TV aparatin sërish dhe zëri i TV aparatit del nga altoparantët e sistemit automatikisht.

Audio Return Channel (ARC)

Nëse TV aparati është kompatibel me Audio Return Channel (ARC) teknologji, HDMI kordoni i lidhur gjithashtu dërgon audio sinjal nga TV aparati në sistem. Nuk duhet të bëni lidhje tjetër të zërit për të dëgjuar zërin e TV aparatit nga sistemi.

One-Touch Play

Kur të lëshoni pajisjen e lidhur me sistemin me HDMI kordon, TV aparati i lidhur kyçet automatikisht dhe sinjali hyrës i sistemit kyçet në sinjalin përkatës të HDMI.

Shënime

- Veçoritë më lartë mund mos të funksionojnë me disa pajisje.
- Varësisht nga rregullimi i pajisjes së lidhur, Control for HDMI funksioni mund mos të punojë mirë. Shikoni manualin e pajisjes.

Përdorimi i “BRAVIA” Sync veçorive

Funksionet origjinale Sony më poshtë mund të përdoren edhe me ndukte që janë kompatible me “BRAVIA” Sync.

Kursimi i energjisë

Nëse një TV kompatible me “BRAVIA” Sync është lidhur me sistemin, harxhimi i rrymës zvogëlohet në modin Standby duke e ndaluar transmetimin e HDMI sinjalit kur TV aparati është shkyçur.

Shënime mbi HDMI lidhjet

- Përdorni HDMI kordon të shpejtë. Nëse përdorni HDMI kordon standard, 1080p, Deep Color, ose 3D/4K pamjet mund mos të shfaqen mirë.
- Përdorni HDMI kordon të autorizuar.
- Përdorni Sony High Speed HDMI kordon me logon e kordonit.
- Nuk rekomandojmë përdorimin e HDMI-DVI kordonëve konvertues.
- Kontrolloni rregullimin e pajisjeve të lidhura nëse pamja është e dobët ose nëse zëri del dobët nga pajisja e lidhur me HDMI kordon.
- Audio sinjale (frekuenca mostër. Gjatësia bit, etj.) të transmetuar nga HDMI kyçësja mund të shtypen nga pajisja e lidhur.
- Zëri mund të pengohet kur frekuenca mostër ose numri i kanaleve të audio sinjaleve dalës nga pajisja e përdorimit është kyçur.
- Kur pajisja e lidhur nuk është kompatible me teknologji për mbrojtje (HDCP), pamja dhe/ose zëri nga HDMI OUT ARC (TV) kyçësja mund

prishet ose mund aspak mos të emetohet. Nëse këtë rast, kontrolloni specifikat e pajisjes së lidhur.

- Kur "TV" është zgjidhur si burim hyrës në sistemin, video sinjalet të HDMI IN kyçëset që ishte zgjedhur herën e fundit do të emetohet nga HDMI OUT ARC(TV) kyçësja..
- Ky sistemi përmban Deep Color, "x.v.Colour," 3D, dhe 4K transmetim.
- Për të shikuar 3D pamje, lidhur TV kompatible me 3D dhe pajisjen (Blu-ray Disc player, "PlayStation®3," etj.) me sistemin me anë të High Speed HDMI kordonët, vendosni 3D syzet dhe pastaj lëshoni Blue-ray disk kompatible me 3D.
- Për të shikuar 4K pamje, TV dhe aparatet që janë lidhur me sistemin duhet të jenë kompatible për 4K pamje.

Mënjanim i problemeve

Nëse përjetoni ndonjë prej vështirësive më poshtë gjatë përdorimit të sistemit, përdorni këto udhëzime për të tejkalluar problemin para dërgimit në servisit. Nëse problemi vazhdon, kontrolloni distributorin më të afërt Sony.

RRYMA

Rryma nuk kyçet.

→ Kontrolloni kordonin e rrymës (krvesorin) a është lidhur mirë.

Sistemi shkyçet automatikisht.

→ "A. STBY" funksioni është kyçur. Vendosni "A. STBY" në "OFF"

(shikoni "Përshtatja e rregullimeve" në Manualin për përdorim).

ZËRI

Nuk emetohet zëri i TV aparatit nga sistemi.

→ Siguroni që burimi i duhet hyrës është zgjedhur. Duhet të provoni sinjale tjera hyrëse duke shtypur INPUT butonin disa herë (shikoni "Dëgjimi i zërit" në Manualin për përdorim).

→ Kontrolloni lidhjen e HDMI kordonit, kordonin digjital optik ose audio kordonin që është lidhur me sistemin dhe TV aparatit (shikoni "Lidhjet" në Manualin e përdorimit).

→ Kontrolloni që "TV" shfaqet si burim hyrës në panelin e përparmë.

→ Kontrolloni emetimin e zërit të TV aparatit.

→ Kontrolloni për të siguruar që zëri i TV aparatit mos të jetë i ulët ose heshtur.

→ Kur një TV aparat kompatible me Audio Return Channel (ARC)

Teknologji lidhet me HDMI kordon, kontrolloni që të siguron se kodoni të jetë i lidhur në HDMI (ARC) kyçësen e TV-së.

→ Nëse TV aparatit nuk është kompatible me Audio Return Channel (ARC)

teknologji, lidhni kordonin digjital optik si mbështetje të HDMI kordonit për të emetuar zërin.

Zëri emetohet nga sistemi dhe TV aparatit.

→ Shkyçeni zërin e sistemit ose TV aparatit.

Zëri mbetet mbrapa pamjes në TV.

→ Vendos "SYNC" në "OFF" nëse është vendosur në 1 deri 4 (shikoni "Rregullimi i parametrave" në Manualin e përdorimit).

Nuk dëgjohe zë ose një zë i ulët dëgjohe nga pajisja e lidhur me sistemin ose subwoofer.

→ Shtypni VOL + dhe kontrolloni nivelin e zërit (shikoni "Pjesët dhe kontrollet" në Manualin e përdorimit).

→ Shtypni MUTE në telekomandë ose VOL + për të anuluar funksionin e heshtjes (shikoni "Pjesët dhe kontrollet" në Manualin e përdorimit).

→ Kontrolloni që gjithë kordonët dhe telat e sistemit janë të lidhur dhe vendosur mirë.

→ Kontrolloni që burimi hyrës të jetë mirë i zgjedhur. Duhet të provoni sinjale tjera hyrëse duke shtypur INPUT butonin disa herë (shikoni "Dëgjimi i zërit" në Manualin për përdorim).

→ Kontrolloni që burimi hyrës të jetë mirë i zgjedhur.

→ Kontrolloni që gjithë kordonët dhe telat e sistemit janë të lidhur dhe vendosur mirë.

→ Shtypni SW VOL + në telekomandë për të ngritur nivelin e zërit të subwoofer (shikoni "Pjesët dhe kontrollet" në Manualin e përdorimit).

→ Subwoofer-i përdoret për zërin bas. Në rast të sinjalit hyrës që përmban pak bas në komponentët (p.sh. TV emetim), zëri nga subwoofer mund mos të dëgjohe fare.

Vazhdon

Dolby Digital ose DTS multi-channel zëri nuk emetohet.

→ Kontrolloni audio rregullimet e Dolby Digital ose DTS formatit në Blu-ray Disc player, DVD player, etj., të lidhur me sistemin.

Efekti i surround nuk mund të fitohet.

- Varësisht nga sinjali hyrës dhe rregullimi i SOUND MODE, përpunimi i zërit surround mund mos të punojë. Efekti i surround mund të jetë i dobët varësisht nga programi ose disku.
- Nëse lidhni Blu-ray Disc player ose DVD player kompativil me funksionin e efektit surround, efekti i sistemit mund mos të punojë. Në këtë rast, efekti i surround i pajisjes së lidhur vendoset në shkyç. Për detaje, shikoni udhëzimet për përdorim të pajisjeve të lidhura.

BLUETOOTH

BLUETOOTH nuk mund të kompletohet.

→ Siguroni që BLUETOOTH indikatori ndriçon ngjyrë blu (shikoni “dëgjimi i audio nga BLUETOOTH aparatet në manualin e përdorimit).

Statusi i sistemit	Statusi i indikatorit
Gjatë BLUETOOTH çiftimit	Ndriçon shpejtë ngjyrë blu.
Sistemi orvatet të çiftohet me BLUETOOTH aparat	Ndriçon ngjyrë blu.
Sistemi ka vendosur lidhjen me BLUETOOTH aparatin	Vazhdon të ndriçojë ngjyrë blu.
Sistemi është në BLUETOOTH standby mod (kur sistemi është shkyçur)	Ndriçon ngadalë ngjyrë blu.

- Siguroni që BLUETOOTH aparatit që do të lidhet është kyçur dhe BLUETOOTH funksioni është aktivizuar.
- Gjejini këtë sistem dhe BLUETOOTH aparatin dhe afroheni.
- Çiftoni sistemin dhe BLUETOOTH aparatin sërish.
- Ndoshta duhet të anuloni çiftimin me këtë sistemi duke e bërë nga BLUETOOTH aparatit njëherë.

Çiftimi nuk mund të bëhet.

- Afroni këtë sistem dhe BLUETOOTH aparatin më afër (shikoni "Dëgjimi i zërit nga BLUETOOTH aparatet" në manualin e përdorimit).
- Siguroni që ky sistem nuk pranon pengesa nga ndonjë rrjet interneti pa tel përveç 2.4 GHz aparate, ose furrë mikrovalë. Nëse ndonjë aparat që gjeneron radioacion elektromagnetik është afër, larohehi atë aparat më larg sistemit.

BLUETOOTH lidhja shkëputet.

Nuk del zë nga aparati i lidhur.


- Afroni këtë sistem dhe BLUETOOTH aparatin më afër
- Nëse ndonjë aparat që gjeneron radioacion elektromagnetik është afër, larohehi atë aparat më larg sistemit.
- Largoni pengesat mes këtij sistemi dhe BLUETOOTH Aparatit ose largojeni sistemin më larg pengesës.
- Ndryshoni pozitën e BLUETOOTH aparatit të lidhur.
- Proveni të ndryshoni frekuencën e ruterit, kompjuterit, etj. në 5 GHz shirit.

Zëri nuk është në sinkronizim me pamjen.

→ Kur shikoni filma, mund të dëgjoni zërin me pak vonesë nga pamja.

TJETËR

Telekomanda nuk funksionon.

- Drejtojeni telekomandën në censorin për pranimin e sinjalit  Në sistem (shikoni "Pjesët dhe kontrollet" në manualin e përdorimit).
- Largoni pengesat në rrugë mes telekomandës dhe sistemit.
- Ndryshoni dy bateritë në telekomandë me të reja, nëse janë të dobëta.
- Siguroni që jeni duke shtypur butonat e duhura në telekomandë.

Control for HDMI funksioni nuk punon mirë.

- Kontrolloni HDMI funksionin.
- Vendosni Control for HDMI funksionin në TV aparatin.

- Siguroni që çdo pajisje e lidhur të jetë kompatible me "BRAVIA" Sync.
- Kontrolloni Control for HDMI parametrat në pajisjen e lidhur. Shikoni manualin e përdorimit që vije me pajisjen e lidhur.
- Nëse lidhni/çlidhni kordonin e rrymës (kryesorin), pritni për më tepër se 15 sekonda dhe përdorni sistemin.
- Nëse lidhni audio sinjalin e video pajisjes dhe sistemin me kordon tjetër nga HDMI kordoni, mund mos të emetohet zëri aspak fare për shkak të BRAVIA" Sync. Në këtë rast, vendosni "CTRL" në "OFF" (shikoni "Rregullimi i parametrave" në manualin e përdorimit) ose lidhni kyçësen e zërit drejtpërdrejt me TV në vend nëpërmjet sistemit.

"PRTECT (protect)" paraqitet në panelin e përparmë.

- Shtyp butonin për të shkyçur sistemin. Pasi "STBY" të zhduket, largojeni karrikuesin (kryesorin), pastaj sigurini që asnjë nuk i bllokon vrimat e ventilimit të sistemit.

RESET

Nëse sistemi akoma nuk punon si duhet, rifillojeni sistemin sipas hapave më poshtë:

- 1 Shtyp butonin për të kyçur subwoofer.**
- 2 Shtyp butonin duke e shtypur INPUT dhe VOL - në subwoofer.**
"RESET" paraqitet dhe sistemi është rifilluar. Menyja kryesore, SOUND, etj., rikthehet në rregullimet fabrike.

Specifikimet

Shufra altoparlant (SS-ST3)

Altoparlantë të përparme D/M

Sistemi i altoparlantit

Sistemi 2 kahu alto, Lloji pasiv radiator

Altoparlanti

Woofër: 30 mm × 100 mm lloji kon

Tweeter: 14 mm lloji i rrethit

Passive radiator: 30 mm × 100 mm lloji kon

Impedanca e matur

3 ohm

Altoparlanti i mesëm

Sistemi i altoparlantit

Sistemi 2 kahu alto, lloji suspension akustik

Altoparlanti

Woofër: 30 mm × 100 mm lloji kon × 2

Tweeter: 14 mm lloji i rrethit

Impedanca e matur

3 ohm

Në përgjithësi

Dimensione (rreth) (w/h/d)

900 mm × 40 mm × 32.5 mm (pa mbajtëse)

900 mm × 42 mm × 30 mm (me mbajtëse)

Pesha (rreth)

0.9 kg (me mbajtëse)

Subwoofer (SA-WST3)

Seksioni i përforcuesit

RRYMA DALËSE (e matur)

Front L + Front R: 15 W + 15 W (në 3 ohm, 1 kHz, 1 % THD)

RRYMA DALËSE (reference)

Front L / Front R alto: 25 W × 2 (për kanal në 3 ohm, 1 kHz)

Alto qendror: 25 W × 2 (për kanal në 3 ohm, 1 kHz)
Subwoofer: 75 W × 2 (për kanal në 4 ohm, 100 Hz)

Hyrje

HDMI IN 1/2/3*
DIGITAL IN TV/OPT
ANALOG IN

* Këto 3 kyçëse janë identike. Cilindo të përdorni, nuk bën dallim.

Dalje

HDMI OUT ARC(TV)

Seksioni i altoparlantëve

Sistemi i altoparlantëve

Subwoofer, Bass Reflex

Altoparlantë

100 mm × 150 mm lloji kon × 2

Impedanca e matur

4 ohm

BLUETOOTH seksioni

Sistemi i komunikimit

BLUETOOTH versioni i specifikuar 3.0

Dalje

BLUETOOTH Specification Power Class 2

Diapazoni maksimal i komunikimit

Linjë e shikimit rreth 10 m¹⁾

Numri maksimal i aparateve që mund të regjistrohen

9 aparate

Shiriti i frekuencës

2.4 GHz shirit 2.4000 GHz - 2.4835 GHz)

Metoda e modulimit

FHSS (Freq Hopping Spread Spectrum)

Profile kompatible BLUETOOTH²⁾

A2DP (Advanced Audio Distribution Profile)

AVRCP 1.3 (Audio Video Remote Control Profile)

Kodeksat e përmbajtur³⁾

SBC⁴⁾, AAC⁵⁾, aptX

- 1) Distanca e vërtetë do të dallojë varësisht nga faktorët siç janë pengesat mes aparateve, fushat magnetike përreth, furrë mikrovalë, elektricitet statik, telefon pa tel, ndjeshmëria e pranimit, sistemi operativ, aplikacioni i softuerit, etj.

2) BLUETOOTH profilet standarde tregojnë qëllimin e BLUETOOTH komunikimit mes aparateve.

3) Kodeks: Kompresion dhe konversioni i formateve

4) Kode nën-shirit

5) Advanced Audio Coding

Në përgjithësi

Kërkesat e rrymës

220 V - 240 V AC, 50 Hz/60 Hz

Konsumimi i rrymës

Kyç: 40 W

Në Standby mod "Control for HDMI" është shkyç dhe BLUETOOTH

Standby modi është shkyç : 0.5 W ose më pak

Dimensione (rreth)

430 mm × 135 mm × 370.5 mm (w/h/d)

Pesha (rreth)

8.2 kg

Formatet digjitale audio që përmbahen nga sistemi

Dolby Digital

DTS-HD High Resolution Audio* DTS-

Dolby TrueHD*

HD Low Bit Rate*

DTS

Linear PCM 2ch 48 kHz ose më pak

DTS 96/24

Linear PCM Maximum 7.1ch 192 kHz ose më pak*

DTS-HD Master Audio*

* Këto formate mund të përdoren vetëm me HDMI lidhje.

Video formatet që përmbahen nga sistemi

Hyrje/Dalje (HDMI Repeater block)

Skedar	2D	3D		
		Paketim i kornizës	Përballë (gjysmë)	Mbi-Nën (Lart dhe poshtë)
4096 × 2160p @ 23.98/24 Hz	棟	玨	玨	玨
3840 × 2160p @ 29.97/30 Hz	棟	玨	玨	玨
3840 × 2160p @ 25 Hz	棟	玨	玨	玨
3840 × 2160p @ 23.98/24 Hz	棟	玨	玨	玨
1920 × 1080p @ 59.94/60 Hz	棟	玨	棟	棟
1920 × 1080p @ 50 Hz	棟	玨	棟	棟
1920 × 1080p @ 29.97/30 Hz	棟	棟	棟	棟
1920 × 1080p @ 25 Hz	棟	棟	棟	棟
1920 × 1080p @ 23.98/24 Hz	棟	棟	棟	棟
1920 × 1080i @ 59.94/60 Hz	棟	棟	棟	棟
1920 × 1080i @ 50 Hz	棟	棟	棟	棟
1280 × 720p @ 59.94/60 Hz	棟	棟	棟	棟
1280 × 720p @ 50 Hz	棟	棟	棟	棟
1280 × 720p @ 29.97/30 Hz	棟	棟	棟	棟
1280 × 720p @ 23.98/24 Hz	棟	棟	棟	棟
720 × 480p @ 59.94/60 Hz	棟	玨	玨	玨
720 × 576p @ 50 Hz	棟	玨	玨	玨
640 × 480p @ 59.94/60 Hz	棟	玨	玨	玨

Dizajni dhe specifikimi janë lënë e ndryshimit pa asnjë paralajmërim.

Informacion në lidhje me produktet e sigurta për mjedisin

- Harxhimi i rrymës në Standby: 0.5 W ose më pak.
- Mbi 85% efikasitet i rrymës së bllokuesit të përforcuesit arrihet me përforcues të plotë digjital, S-Master.

HDMI

x.v.Colour

DOLBY
TRUEHD

dts-HD

Bluetooth®

N™

aptX
CSR

<http://www.sony.net/>



* 4 4 6 7 1 4 7 1 1 * (1)